

ЦВЕТАН ГАВРОВСКИ
СЛИКАЊЕ СО СВЕТЛИНА



PAINTING WITH LIGHT
CVETAN GAVROVSKI

Botohet monografia "Fotografimi me dritë" e Dr. Cvetan Gavrovski

Shkup, 17 dhjetor - Shtëpia botuese "Matica makedonska" publikoi librin "Fotografimi me dritë" nga Cvetan Gavrovski, mjeshtër nacional i fotografisë dhe EFIAP i Federatës botërore të artit të fotografisë. Në 370 faqe me dy cikle, në bardh e zi dhe në ngjyra, në libër janë prezantuar rreth 200 fotografi me narrativ të shkurtë. Punimi është në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze me tekst për një pamje autoriale të fotografisë krijuese si mjet artistik i shprehjes. Gavrovski është fotograf artistik, me 40 vjet prezencë krijuese në botën e krijuar nëpër objektivin e aparatit të fotografisë dhe është një nga autorët më të eksponuar të Maqedonisë. Ai i zbulon sekretet e "nënshkrimit fotografik" të tij dhe të cilat janë aspiratat e tij autoriale. "Më së shumti dua që përmes fotografisë ta shfaqim atmosferën dhe kohën. Ato e shpjegojnë të tashmen. Nesër me siguri do të përballem me ndonjë kërkesë të shërbejnë si shpjegim për një të vërtetë, për një periudhë", është shprehur Gavrovski. Cvetan Gavrovski (1947) është doktor i shkencave teknike nga fusha e elektroteknikës dhe është profesor i rregullt në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup. Art fotografia është preokupimi i tij më shumë se 40 vite. Ka marrë pjesë në më shumë se dyqind ekspozita grupore në vend dhe jashtë vendit. Autor është i 12 ekspozitave në Maqedoni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Gjermani, Serbi, Slloveni. Vlerësimet dhe kritikimet e tij për fotografinë janë publikuar në revista dhe në shtypin ditor. Fitues është i shumë shpërblimeve të rëndësishme për fotografinë e ekspozitave vendore dhe ndërkombëtare i medaljeve të arit dhe argjendit nga asociacione botërore dhe ndërkombëtare. Ka qenë anëtar i komisionit të ekspozitave ndërkombëtare nën patronazhin e federatave ndërkombëtare të art fotografisë. Është pjesëmarrës i më shumë kolonive ndërkombëtare të artit. Është përfaqësues i Image Colleague Society International - USA për Maqedoninë. Anëtar i foto klubit akademik ELEMA nga Shkupi. Ka qenë kryetar i klubit dhe ka dhënë kontribut të madh për afirmimin e tij. Në dy raste ka qenë kryetar i Lidhjes së fotografistëve të Maqedonisë, si dhe anëtar i kryesisë së Lidhjes së fotografistëve të Jugosllavisë. (K.S. Andonova)

SEANCA E KUVENDIT TË LSHPM

JETA E PENSIONISTËVE ËSHTË MË E RËNDËSISHMJA

Në Programin për vitin 2021 të LSHPM-së, gjëja më e rëndësishme është jeta e pensionistëve. Lidhja do të këmbëngul që ai të jetë më kualitativ dhe më i pasur në përmbajtje edhe krahas pandemisë nga virusi

Shkup, 17 dhjetor - Kuvendi i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë më 24 dhjetor do ta mbajë seancën e saj të katërt. Seancës së Kuvendit i parapriu seanca e Këshillit ekzekutiv në të cilën u shqyrtuan dhe u miratuan Programi i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë për vitin 2021. Seanca e pesëmbëdhjetë e Këshillit ekzekutiv të Lidhjes u mbajt më 9 dhjetor. Në seancë morën pjesë edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM-së, M-r Ilija Adamoski.

Fillimisht, kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova potencoi që kjo është seanca e fundit e KE të LSHPM për vitin 2020 dhe si zakonisht u theksuan aktivitetet më të rëndësishme në periudhën mes dy seancave, edhe atë, është dërguar iniciativë deri te Qeveria për ndryshimin e nenit 105 në Ligjin për shtëpitë e personave të moshuar dhe shtëpitë pensioniste; është realizuar takimi me drejtoreshën Biljana Jovanovska në Fondin e PIO-SM në të cilin është lidhur bashkëpunim i frytshëm në interes të pensionistëve; linja



Shkup, 17 dhjetor - Kur bëhet fjalë për aktivitetet më të mirë në SHP Çair, pa dyshim që personat udhëheqës të shoqatës e veçuan pensionistin Rashid Idrizi, anëtar i Komisionit për sport dhe anëtar i Kuvendit. Vitet e tij janë shumë, por ai duket që nuk po i ndien. Vitaliteti i tij për vitet që i ka me nxitën që të flas për dashurinë e tij ndaj sportit, të cilin e përcjell që në vegjëli, që nga ditët shkollore, ndërsa veçanërisht disiplina e kërcimit nga vendi, kur gjatë pauzave nxënësit janë mahinur nga sukseset e tij. Sot, Rashid Idrizi edhe pse ka filluar ta konsumojë dekadën e tetë, është vital dhe aktiv, dhe mund ta takojmë në shoqatë ose në dyqanin e tij.

Cjatë takimit, me modesti të madhe, i



telefonike 3213 227 në mënyrë të vazhdueshme funksionon dhe pyetjet e marra do të parashtrihen deri te Këshilli për siguri nacionale; disa shënime janë parashtruar edhe deri te MPPS, Ministria e shëndetësisë dhe deri te Qeveria; është ngritur çështja rreth vaksinimit të pensionistëve në nivel më të lartë; doli nga shtypi Buletini për revytë e 18-ta rajonale të këngës, muzikës dhe lojërave dhe revyja e 10-të folklorike jubilarë dhe gjëra të tjera.

Pastaj kryetarja dha pasqyrë koncize cilësore të Programit për punë të Lidhjes për vitin 2021 duke i theksuar aktivitetet më të rëndësishme. Mes tjerash, ajo potencoi që në Programin për vitin 2021 të LSHPM-së, gjëja më e rëndësishme është jeta e pensionistëve. Lidhja do të këmbëngul që ai të jetë më kualitativ dhe më i pasur në përmbajtje edhe krahas pandemisë nga virusi.

Në bazë të debatit nga të pranishmit, Programi si dhe Plani financiar i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë për vitin 2021, të cilin e shpjegoi sekretari i LSHPM, Menka Temelkovska, u miratua njëzëri. Informacionin për përcaktimin e të dhënave sipas shoqatave të pensionistëve dhe Informacionin për mjetet e paguara për fondin solidar (ndihma pas vdekjes) të shfrytëzuesve të pensionit, për periudhën janar-shtator 2020 i shpjegoi nënkryetari i Këshillit ekzekutiv Mentor Qoku, ndërsa u sollën edhe disa vendime të rëndësishme për punën aktuale të Lidhjes. Seanca u mbajt me respektimin e të gjitha masave për mbrojtjen e shëndetit të të pranishmëve. Kjo ishte seanca e fundit për vitin 2020. (K.S. Andonova)

SHPÇAIR

RASHID IDRIZI, AKTIVIST PËR SHEMBULL

shprehte me ndrojtje aktivitetet e tij, për punën dhe jetën pensioniste. Përderisa shpjegonte, i shqyrtonte fotografitë e viteve të aktiviteteve të shumta dhe u rikujtua për ngjarjet e shumta. Rashidi edhe kur ka punuar ka gjetur kohë për trajnim. Krahas me aktivitetin sportiv, ai është i njohur edhe si një nga TV mjeshtret më të mirë. Ai thotë se sportit dhe zanatit ia ka kushtuar jetën e tij.

Përndryshe, pensionisti Rashid Idrizi është i lindur në vitin 1949 në fshatin Nikish-tan, rrethina e Shkupit. Në vitin 1959 janë shpërngulur në Shkup, ku e mbaroi arsimin fillor dhe të mesëm. Në vitin 1964 filloi ta mësojë zanatin për mjeshtër të televizorëve në TV servis "Radio Bran", ku ka punuar edhe baba i tij. Nga viti 1973 tërësisht iu përkushtua zanatit, të cilin e ka mësuar dhe trashëguar nga babai i tij, dhe e hap dyqanin e tij personal në lagjen Çair. Nga ajo ditë mjeshtëri i mirë ka qenë i kërkuar nga të gjithë. Në vitin 2013, mjeshtri i televizorëve Rashid Idrizi është pensionuar dhe menjëherë është kyçur në aktivitetet e Shoqatës, ndërsa biznesin e tij e vazhdoi djali i tij, Dritoni, i cili është trajner i hendbollit dhe nipi i tij Enesi, i cili është lojtar në KH Rabotnički. Edhe Dritoni edhe Enesi e kanë trashëguar zanatin, por edhe dashurinë ndaj sportit, që është një gë-

zim i madh i Rashidit, i cili edhe sot një pjesë të kohës e kalon në dyqan dhe iu ndihmon djalit dhe nipit. "Ky është biznes familjar, por këtu bën pjesë edhe sporti. Pensionimi akoma më shumë më afro ndaj sportit. Gjithmonë garoj me entuziazmin e një sportisti për çdo pikë dhe centimetër të fituar, me qëllim të fitoj vend më të lartë edhe për veten edhe për shoqatën. Të gjitha sukseset nuk do t'i kisha arritur pa mbështetjen e udhëheqësisë së shoqatës. Në ditët e pensionimit e gjeta paqen dhe qetësinë në shoqatë, ndërsa me shoqërimin dhe rekreacionin aktiv, vetëm e përmbusha imazhin e jetës së bukur të pensionimit. Kur do, gjithçka është e mundur, veçanërisht kur ekzistojnë kushte të cilat i ofron Shoqata jonë", thotë i palodhshmi Rashid, duke cekur një pjesë të aktiviteteve në Shoqatë.

Ai tashmë gjashtë vjet merr pjesë në garat sportive në disiplinën kërcim nga vendi, në nivel rajonal dhe republikan, ku ka fituar gjashtë vende të larta në nivel rajonal dhe një vend të tretë në nivel republikan në vitin 2014. Shembulli i Rashid Idrizit është dëshmi që dëshirën për shoqërim dhe sport të pensionistëve nuk e kufizojnë vitet. Aktivitetet e pensionistëve sjellin shëndet, ndërsa sukseset kënaqësi dhe gëzim. Vasil Paçemski